



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 393/12 prot.

Tiranë, 12.10.2018

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 46, datë 24.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Xhezair Zaganjori.
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 28.09.2018, është njoftuar vendimi nr. 46, datë 24.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin në rivlerësim z. Xhezair Zaganjori, gjyqtar/kryetar i Gjykatës së Lartë.

Ndaj këtij vendimi, në zbatim të nenit B, pika 3, germa “c” e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 28.9.2018, është depozituar akti “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”, nënshkruar nga tre vëzhgues ndërkombëtarë të ONM-së.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afati ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 46, datë 24.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori, prej periudhës janar 2003-prill 2013, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe prej prillit 2013 e aktualisht ushtron detyrën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* me përparësi në kohë.

2. Mbështetur në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit ndaj z. Xhezair Zaganjori ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (në vijim referuar si Inspektorati), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Xhezair Zaganjori*<sup>1</sup>”, ka referuar se:

- i. *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin<sup>2</sup>, ka referuar “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*”.

2.3 Inspektorati i KLD-së, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit 84/2016, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit<sup>3</sup>, nga analiza e të cilit, së bashku me vlerësimin e denoncimeve nga publiku (9 të tilla), Komisioni nuk ka gjetur elementë që mund të ngrënë dyshime për aftësinë profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, duke arritur në konkluzionin se subjekti ka arritur një nivel kualifikues vlerësimi të aftësive profesionale.

3. Komisioni pas hetimit administrativ (zhvilluar gjatë periudhës 13.11.2017 - 26.6.2018) dhe vlerësimit të fakteve dhe rrethanave lidhur me kontrollin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për secilin kriter, në mënyrë të përmbledhur ka arritur në përfundimet si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Bazuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, Komisioni gjatë hetimit administrativ është ndalur në kontrollin e deklarimeve të subjektit ndër vite, në deklaratën Vetting dhe vlerësimin e saktësisë, mjaftueshmërisë dhe burimin e ligjshëm të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, hetim nga i cili kanë rezultuar disa gjetje/problematika. Në këto kushte, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime dhe bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar barrën e provës<sup>4</sup> për të vërtetuar të kundërtën e gjetjeve, përmbledhur si vijon:

3.1.1 Mospërputhje midis deklarimeve për vleftën e pasurisë *apartment banimi me sip. 293 m<sup>2</sup>*, me vendndodhje rruga “\*\*\*\*” \*\*\*.

<sup>1</sup> Protokolluar pranë Komisionit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2017.

<sup>2</sup> Shkresa e DSIK me nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2017 (deklasifikuar plotësisht).

<sup>3</sup> Shkresa e Inspektoratit të KLD-së, nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2017.

<sup>4</sup> Referoju akteve në dosje.

- 3.1.2 Mospërputhje midis deklarimeve për vleftën e pasurisë *njësi shërbimi (dyqan)*, me vendndodhje rruga “\*\*\*\*” \*\*\*.
- 3.1.3 Mospërputhje midis deklarimeve për vleftën e pasurisë *bodrum me sip.65 m<sup>2</sup>*, me vendndodhje rruga “\*\*\*\*” \*\*\*.
- 3.1.4 Mospërputhje midis deklarimeve për vleftën e pasurisë *zyrë me sip. 15m<sup>2</sup>*, me vendndodhje rruga “\*\*\*\*” \*\*\*.
- 3.1.5 Vërtetimin e burimit të ligjshëm dhe veprimet bankare për blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 81 m<sup>2</sup>, me vendndodhje \*\*\*.
- 3.1.6 Paraqitjen e provave lidhur me deklaratimet e bëra për pagesën prej 35.000 USD + 1.2 milionë lekë, kryer nga subjekti në dhjetor të vitit 2008 kundrejt shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.
- 3.1.7 Vërtetimin me dokumentacion provues për shpenzimet për shkollimin e të birit \*\*\*.\*\*\* në Mbretërinë e Bashkuar, periudha 2008-2013.
- 3.1.8 Vërtetimin me dokumentacion provues për shpenzimet për shkollimin e të birit \*\*\*.\*\*\* në RFGj, periudha 2013-2016.
- 3.1.9 Detyrimin për të deklaruar vlerën e saktë e të ardhurave nga qiraja për periudhën 1997-2001 dhe pas vitit 2001.
- 3.1.10 Mosdeklarimin e gjendjes së llogarive bankare në emër të bashkëshortes në deklaratën periodike për vitet 2005, 2006 dhe mosdeklarimi i llogarisë bankare në emër të subjektit për vitin 2007.
- 3.1.11 Mospërputhje midis deklarimeve për të ardhurat nga instituti gjerman “\*\*\*\*” dhe paraqitjen e dokumentacionit mbështetës për vërtetimin e këtyre të ardhurave.

**3.2** Komisioni, pas administrimit dhe vlerësimit të pretendimeve dhe provave të dorëzuara nga subjekti mbi gjetjet e mësipërme, në përfundim ka konkluduar se *“... rezulton se subjekti ka pasaktësi dhe mospërputhje të deklarimeve të mëparshme me deklaratën Vetting. Në lidhje me këtë, Komisioni arsyeton se pika 2, e nenit D, të aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar detyrimin e subjektit të dorëzojë/plotësojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë... Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me Deklaratën e re të Pasurisë, dhe jo me deklaratimet e mëparshme të tij. Këto deklarime mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të jenë shkak për shkarkimin e subjektit. Konkluzioni përfundimtar i Komisionit do të duhet të nxirret nga motivi dhe sjelljet e subjektit, nga mënyra e plotësimit të Deklaratës-Vetting dhe nga të dhënat e hedhura në të. Përdorimi i deklarimeve në vite shërben për të analizuar vlerën e kësaj prove në raport me provat e tjera, me qëllim përcaktimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë. Komisioni arsyeton se pasaktësitë në deklarimet e viteve të kaluara nuk lidhen me deklarin e pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016. Nxjerrja e konkluzionit për “deklarim të pamjaftueshëm” në lidhje me pasurinë, bëhet mbi bazën e shkakut kushtetues, kur vërtetohet se subjekti, sipas Deklaratës-Vetting nuk arrin të justifikojë burimin e ligjshëm të pasurisë apo kur tenton të kryejë fshehje apo deklarim të rremë të pasurisë. Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e këtyre pasaktësive, në raport me provat e tjera të administruara... Komisioni konstaton se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti Xhezair Zaganjori ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë”*(f. 35-36 e vendimit).

**3.3 Për kontrollin e figurës.** Bazuar në nenin DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka konstatuar se nuk është gjetur asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit. Subjekti është gjendur në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.

**3.4 Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Bazuar në nenin E të aneksit të Kushtetutës, nenin 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni pas administrimit dhe analizimit të raportit të përgatitur

nga Inspektorati i KLD-së, vlerësimin të 9 denoncimeve nga publiku, në përfundim ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale.

4. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit z. Xhezair Zaganjori, me detyrë kryetar i Gjykatës së Lartë.

## **II. Shkaqet e ankimit**

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar (Vetting).

6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës, nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e këtij të fundit, pa pasur mundësinë ai vetë (Komisioneri), që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave.

8. Në të tilla rrethana ligjore, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit.

9. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik bazuar në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, nga shqyrtimi i vendimit nr. 46, datë 24.7.2018, dhe provave të administruara për këtë qëllim nga Komisioni, në konsideratë edhe të rekomandimit të ONM-së (bashkëlidhur këtij ankimi), vlerëson se vendimi përmban shkaqe të mjaftueshme për t’iu paraqitur juridiksionit rishikues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit për vendimmarrje.

9.1 Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, Komisioneri Publik konstaton se për sa i takon kriterit të pasurisë, referuar kërkesave të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, përfundimet e Komisionit nuk janë në pajtueshmëri me aktet dhe provat e administruara.

9.2 Në këtë drejtim, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (periodike dhe ajo Vetting), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe personave të lidhur (e paluajtshme/e luajtshme/likuiditetet). Me pasuri të ligjshme, për qëllim të këtij përcaktimi kushtetues, konsiderohen vetëm ato të cilat janë deklaruar (saktësisht dhe mjaftueshmërisht) dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

9.3 Sa më sipër, Komisioneri Publik, referuar provave dhe gjetjeve nga hetimi administrativ në balancë me dokumentet dhe pretendimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, çmon se ky i fundit për kriterin e kontrollit të pasurisë nuk arrin të përmbushë detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin D, të aneksit të Kushtetutës. Referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 (barra e provës), subjekti nuk ka arritur të provojë me prova dhe shpjegime bindëse të kundërtën e rezultateve të hetimit, rrjedhimisht edhe përfundimet e arritura nga Komisioni për vlerësimin e pasurisë së subjektit nuk gjenden të drejta.

10. Në këto kushte, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës si dhe nenit 4 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 46, datë 24.7.2018, të Komisionit, ushtrohet për vlerësimin e gabuar të kriterit të pasurisë të subjektit të rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori.

## II.A Vlerësimi i Komisionerit Publik mbi interpretimet ligjore të Komisionit

11. Komisioneri Publik konstaton se në arritjen e përfundimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Komisioni është mbështetur në arsyetime dhe interpretime të gabuara lidhur me përmbajtjen dhe zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe legjisllacionit të posaçëm.

12. Kështu, Komisioneri Publik nuk pajtohet me sa parashtron dhe konkludon Komisioni<sup>5</sup> lidhur me interpretimin e nenit D të Kushtetutës, ku ndërmjet të tjerash, në vendimin konkret arsyeton se “...mospagimi i detyrimeve fiskale pa vërtetuar paligjshmërinë e pasurisë, nuk mund të shërbejë si shkak për dhënien e masave disiplinore në bazë të kësaj dispozite kushtetuese dhe dispozitave ligjore të dala në zbatim të saj” dhe se “Nëse subjekti arrin të sqarojë dhe të provojë burimin e ligjshëm të së drejtës apo detyrimit që ka gjeneruar këto të ardhura apo pasuri, atëherë prezumimi kushtetues dhe ligjor sipas nenit D të Kushtetutës rrëzohet dhe pasuria në optikën e organeve vendimmarrëse të procesit të rivlerësimit kalimtar duhet të kualifikohet si e ligjshme.” Nisur nga rëndësia që paraqet ky interpretim i bërë nga Komisioni dhe efektet më së paku në “bindjen e brendshme”<sup>6</sup> të këtij trupi gjykues në vazhdim të procesit të rivlerësimit në rastin konkret, në vijim paraqesim argumentet, që në vlerësimin e Komisionerit Publik rrëzojnë këtë interpretim të bërë nga Komisioni:

- i Duke pasur në konsideratë se forcimi i sistemit fiskal të shtetit lidhet drejtpërdrejt me pagimin e taksave dhe tatimeve të vendosura me ligj të posaçëm, këto burime financiare të buxhetit të shtetit gëzojnë një mbrojtje të veçantë, duke parashikuar ligjvënësi mospagimin e taksave dhe tatimeve, edhe si figurë veprë penale, që prej vitit 1993<sup>7</sup>. Në këtë këndvështrim, edhe pika 3, e nenit D, të Kushtetutës duhet të konsiderohet si shprehje e kësaj garancie.
- ii Në vlerësimin e Komisionerit Publik, dispozita kushtetuese e pikës 3 të nenit D, kur sanksionon “Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat ...për të cilat janë paguar detyrimet tatimore” jep parimin, mbi bazën e të cilit duhet të veprohet në rastin e “kualifikimit” të pasurisë si të ligjshme, duke referuar te legjisllacioni në fuqi që normon marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimeve. Një prej tyre është ligji me nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili në dy dispozita të tij përcakton se cilat janë të ardhura të tatueshme (neni 8) dhe cilat janë të ardhura të përjashtuara/të patatueshme (neni 9). Sipas këtyre dispozitave ligjore, në zbatim të pikës 3, nenit D, të Kushtetutës, e ardhur e ligjshme do të jetë ajo e ardhur për të cilën provohet se është paguar detyrimi tatimor ose ato të ardhura për të cilat dispozita ligjore në fuqi i ka përjashtuar nga detyrimi për pagimin e tatimit. Pra, në vlerësimin e Komisionerit Publik, është ligji “kualifikuesi” i vetëm i atyre rasteve kur mospagimi i tatimit për shkak të përjashtimit përkatës ligjor të shprehur nuk do të përbëjë shkak për kalimin e barrës së provës dhe mundësisë për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas pikës 5, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, për shkak të deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.

<sup>5</sup> Faqe 27 e vendimit.

<sup>6</sup> Ligji 84/2016, neni 49, pika 4 “...Ata kanë të drejtë të çmojnë sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes”.

<sup>7</sup> Ligji nr. 7769, datë 16.11.1993, “Për disa ndryshime e shtesa në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”.

iii Zbatimi i pikës 4, të nenit D, në vlerësimin e Komisionerit Publik, ka një rrjedhë të tillë interpretimi ligjor në rend kronologjik. Fillimisht, subjektet e rivlerësimit kanë deklaruar ndër vite dhe në deklaratën Vetting pasuritë e tyre. Në vijim, nga kontrolli administrativ që kryhet për burimin e ligjshëm të këtyre pasurive të deklaruara, subjektet e rivlerësimit duhet të provojnë për këto pasuri të deklaruara (i) titullin juridik të krijimit të pasurisë, i cili duhet të jetë detyrimisht, në çdo rast, i ligjshëm, ashtu edhe (ii) pagesën e detyrimit ligjore eventuale, që janë përmbushur, duke u plotësuar në këtë mënyrë të dy kushtet në mënyrë *kumulative*:

- bazohet në titull të ligjshëm (veprim juridik i lejuar nga ligji);
- detyrimi tatimor është paguar ose është i përjashtuar me ligj.

**12.1** Pra, për të arritur në përfundimin e subjekti i rivlerësimit është në pronësi të një “pasurie të ligjshme” duhet të përmbushen detyrimisht në mënyrë kumulative dy kushtet e parashtruara më lart.

**13.** Komisioneri Publik nuk pajtohet me arsyetimin e Komisionit në vendimin konkret, lidhur me trajtimin juridik që duket se i bëhet pikës 3 dhe 4, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, duke i konsideruar elementët që përmbajnë këto dispozita të ndryshme me natyrë *kumulative*<sup>8</sup>. Referuar përmbajtjes së këtij vendimi f. 28-30, Komisioni, pasi citon nenin D të aneksit të Kushtetutës, bën një trajtim të zgjeruar të qëllimit dhe kuptimit të kësaj dispozite, nën arsyetimin e një *interpretimi logjik të këtij kuadri normativ*. Çështjet ligjore të trajtuara në këtë kontekst nga Komisioni mund të grupohen në dy drejtime; (i) qëllimi i procesit të rivlerësimit në raport me deklaratimet ndër vite (vendi që zë deklaratat e re “Vetting” dhe realizimi i kontrollit vetëm sipas kësaj deklarate), (ii) prezumimet ligjore absolute të fajësisë së subjektit të rivlerësimit dhe prezumimi ligjor relativ i burimit të ligjshmërisë, në kuptim të pikës 3 dhe 4, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës.

**13.1** Në lidhje me vendin që zë gjatë procesit të rivlerësimit deklarata Vetting, Komisioneri Publik, risjell në vëmendje qëndrimin e shprehur dhe në ankimin e paraqitur para Kolegjit të Posaçëm të Apelit ndaj vendimit nr. 47, datë 25.7.2018, të Komisionit, në të cilin parashtrohet se:

- Në vlerësimin e Komisionerit Publik, Kushtetuta nuk përcakton se deklarata “Vetting” është dokumenti ligjor nga ku fillon përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit apo që Kushtetuta ta ketë lidhur këtë përgjegjësi drejtpërdrejt me deklaratën “Vetting” dhe jo me deklaratimet e bëra ndër vite. Ky kuptim i thjeshtëzuar devijon qëllimin e dispozitës kushtetuese, që është të identifikojë atë subjekt rivlerësimi, i cili ndodhet në situatën ligjore që justifikon marrjen e masës disiplinore dhe më konkretisht në rastet kur:*
  - ka pasuri më të madhe sesa dyfishi i pasurisë së ligjshme;
  - nuk e ka deklaruar saktësisht pasurinë e tij dhe të personave të lidhur;
  - nuk e ka deklaruar plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur;
  - nuk shpjegon bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij.
- Sikurse është formuluar dispozita kushtetuese, i rëndësishëm është qëllimi (shkaku) dhe pasoja (masa disiplinore që merret) është rrjedhojë e tij. Duke qenë se qëllimi është identifikimi i atyre subjekteve që kanë pasuri nga burime jo të ligjshme, kanë bërë deklarime të rreme, kanë fshehur pasuritë, nuk shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, çdo rrethanë, fakt apo provë është e rëndësishme dhe merr vlerë (çmohet) gjatë hetimit administrativ dhe jo paraprakisht. Në këtë kuptim, Komisioneri Publik ka një qëndrim të kundërt nga sa shprehet Komisioni në vendimin konkret, për sa i përket kuptimit dhe vlerës*

<sup>8</sup> Faqe 30 e vendimit.

*që i jepet deklaratës “Vetting” si shkak i vetëm kushtetues për masën disiplinore të shkarkimit dhe raportit të saj me deklaratat vjetore të bëra ndër vite.*

**13.2** Në lidhje me arsyetimin e Komisionit për (ii) prezumimet ligjore absolute të fajësisë së subjektit të rivlerësimit dhe prezumimi ligjor relativ i burimit të ligjshmërisë në kuptim të pikës 3 dhe 4, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, Komisioneri Publik çmon se pika 3, e nenit D, vendos detyrimin për subjektin e rivlerësimit që të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, ndërsa pika 4 e nenit D parashikon rastin kur subjekti ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkelje disiplinore dhe duhet të paraqes prova të vërtetojës të kundërtën. Këto parashikime kushtetuese qëndrojnë të pavarura nga njëra-tjetra dhe nuk mund të konsiderohen me natyrë kumulative (pa njërin nuk ekziston tjetra). Ky interpretim i Komisionit Publik bazohet dhe në zbatimin që i është bërë kësaj dispozite kushtetuese, nga ligjvënësi në ligjin nr. 84/2016, kur gjen pasqyrim në nenin 61, pika 1 dhe 3 e tij. Në nenin 61, pika 1, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra ndaj subjektit të rivlerësimit jepet: *“Kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të”*, pra sanksionimi kushtetues i pikës 4, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës pasqyrohet në këtë dispozitë ligjore. Ndërkohë, në një dispozitë të ndryshme, e të pavarur, për të arritur në përfundimin e ekzistencës së shkakut të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, ligjvënësi sanksionimin e pikës 3, në lidhje me pikën 5, të nenit D e ka pasqyruar në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, që parashikon: *“Kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit ...pasurisë...”*. Sikurse shihet qartë, neni 61 i ligjit nr. 84/2016, pikat 1 dhe 3, qëndrojnë si raste të veçanta të pavarura nga njëra-tjetra dhe nuk mund të konsiderohet se zbatohen vetëm në mënyrë kumulative.

**14.** Po ashtu, ndër të tjera në këtë vendim, Komisioni arsyeton se *“...organet ad hoc të rivlerësimit kalimtar kanë juridiksion ekskluziv të vlerësojnë vetëm shkeljet sipas ligjit nr. 84/2016, në bazë të Deklaratës-Vetting dhe jo shkeljet e tjera që mund të jenë kryer ndër vite nga subjektet e rivlerësimit, në bazë të deklarimeve të mëparshme, të cilat potencialisht mund të përbëjnë kundërvajtje administrative...”*.

**14.1** Komisioneri Publik vlerëson se ky arsyetim i përdorur nga Komisioni, në rastin konkret, nuk jep argumente mbi shkaqet e deklarimeve të pasakta apo të pamjaftueshme, si dhe të ndryshimit të tyre gjatë procesit të rivlerësimit nga ana e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, ky arsyetim nuk *ndryshon* faktin se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion për të vërtetuar të kundërtën e gjetjeve të hetimit administrativ (barra e provës), megjithëse i është kërkuar posaçërisht nga Komisioni për qëllim të kontrollit të pasurisë, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016. Vlerësojmë se për të mbështetur këtë arsyetim që përdor, Komisioni duhet të identifikonte normën ligjore, që sipas ligjit nr. 9043/2003 apo atij nr. 9367/2005, pasaktësinë/pamjaftueshmërinë e deklarimeve të mëparshme të subjektit apo ndryshimin e tyre përgjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit e kategorizon vetëm si kundërvajtje administrative, fakt ky, me vërtetimin e të cilit, sipas Komisionit, përjashton juridiksionin rivlerësues të Komisionit, në zbatim të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

**14.2** Sa më sipër, Komisioneri Publik çmon se nuk ka bazë ligjore për të hequr nga objekti i kontrollit të pasurisë për qëllim të nenit D të aneksit të Kushtetutës (saktësia dhe mjaftueshmëria e deklaramit), shkelje të mundshme të kryera nga subjektet e rivlerësimit përgjatë viteve kur kanë bërë deklaramin periodik, pasi ato marrin vlerën e provës, ashtu sikurse ligji nr. 84/2016 e parashikon në nenin 32, pika 5 të tij, dhe, së bashku me provat e tjera, vlerësohet në tërësi me rrethanat e çështjes për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë.

**15.** Të pambështetur po ashtu e gjejmë vlerësimin e Komisionit, kur konkludon se në rastin konkret ka hapësira/boshllëk ligjor, të cilin subjekti e ka shfrytëzuar në favorin e tij nëpërmjet

kontratave fiktive, duke shmangur pagesën e detyrimeve tatimore e duke kryer kështu *evazion tatimor të ligjshëm*<sup>9</sup>, trajtuar gjerësisht në vijim të këtij ankimi.

**16.** Komisioneri Publik konstaton se pas kalimit të barrës së provës ndaj subjektit të rivlerësimit, pavarësisht mundësisë që ligji i njeh për të sjellë prova, shpjegimet e dhëna prej tij mbeten në nivel deklarativ, duke mos vërtetuar kështu të kundërtën e gjetjeve të Komisionit. Në këtë rast, sjellim në vëmendje që neni D i aneksit të Kushtetutës, në mënyrë të përsëritur, kërkon që subjekti i rivlerësimit duhet të *provojë të kundërtën apo të vërtetojë të kundërtën*. Qëndrimet deklarative të subjektit nuk mundet të konsiderohen prova. Në rastin konkret, nisur nga rrethanat juridike, vetëm aktet, në formën dhe përmbajtjen e kërkuar nga ligji, mund t'i nënshtrohen testit objektiv të vlerës provuese.

**17.** Siç u trajtua edhe më lart, si një ndër tri kriteret e procesit të rivlerësimit kalimtar, kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë e gjejmë të rregulluar në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe kreun IV të ligjit nr. 84/2016, ku realizimi i qëllimit të nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës për këtë kriter, këto norma e konkretizojnë në identifikimin e subjekteve (i) që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose (ii) ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Për këtë qëllim, nëse gjatë hetimit administrativ, ashtu siç ka ndodhur edhe në rastin objekt ankimi, Komisioni arrin në përfundimin se gjetjet/provat e administruara gjatë hetimit administrativ kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kalon barra e provës për të paraqitur prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën.

**18.** Në vështrim të këtij detyrimi ligjor, Komisioneri Publik çmon se konkluzioni përfundimtar i Komisionit se “...subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të veta, si detyrim kryesor kushtetues i tij”, pas kalimit të barrës së provës, nuk i përgjigjet provave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit. Referuar gjendjes së akteve mbi të cilat Komisioni mori vendimin për konfirmimin në detyrë të z. Xhezair Zaganjori, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të argumentojë dhe provojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, edhe pas kalimit të barrës së provës, duke mos plotësuar kështu, kërkesat e nenit D të aneksit të Kushtetutës. Në arritjen e këtij vlerësimi, analiza në vijim bazohet pikërisht në përcaktimet e kësaj dispozite kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, konkretizuar në elementet si:

- i. **Saktësia dhe mjaftueshmëria** e deklarimeve të subjektit për qëllim të procesit të rivlerësimit (pika 2, e nenit D, dhe sipas rastit, aplikimi i pikës 1 dhe/ose 5, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, lidhur me nenin 32/5 dhe nenin 61/3 i ligjit);
- ii. **Ligjshmëria e pasurisë**, pra shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm të krijimit për pasuritë në pronësi ose përdorim të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të.

## **II.B Vlerësimi i pasurive**

**19.** Pasuritë nga subjekti i rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori, janë deklaruar fillimisht në *Deklaratën e personit, që mbart detyrimin për deklarim pasurie* (këtu e në vijim referuar si DV-2003) dorëzuar në ILDKP më datë 29.3.2004, deklaratat periodike për vitet 2004 - 2016, dhe në *Deklaratën “Vetting”* (këtu e në vijim referuar si D-Vett.) dorëzuar në ILDKPKI në datë 30.1.2017. Pasuritë e deklaruara janë si vijon:

### **19.1 Pasuria nr. 1**

*Në D-Vett. deklarohet:* Apartament banimi me sipërfaqe 293 m<sup>2</sup>, me vendndodhje Rr. “\*\*\*\*”, \*\*\*, me vleftë 5,800,000 lekë, ndërtuar në vitin 1997. Pjesët takuese 50 % me 50 % me bashkëshorten.

<sup>9</sup> Faqet 7 dhe 12 të vendimit.



Si burim i krijimit të pasurisë është deklaruar: të ardhura nga shitja e apartamentit, të ardhura personale dhe qira.

*Në DV-2003 deklarohet:* Apartament banimi me sipërfaqe 200 m<sup>2</sup> +87 m<sup>2</sup> ballkon, me vendndodhje Rr. "\*\*\*\*", \*\*\*, me vleftë **7.400.000 lekë**, ndërtuar në gusht 1997. Pjesët takuese 50 % me 50 % me bashkëshorten. Si burim i krijimit të pasurisë është deklaruar: shitja e apartamentit në Rrugën "\*\*\*\*", 4,000,000 lekë, të ardhura personale 3,400,000 lekë.

*Në fashikull të Komisionit është administruar:* Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., e datës \*\*\*.10.2001, lidhur në \*\*\* para noteres \*\*\*, me palë shitëse \*\*\* dhe \*\*\* me palë blerës \*\*\* dhe Xhezair Zaganjori. Objekti i kontratës është apartament me sipërfaqe 293 m<sup>2</sup>, regjistruar në ZRPP \*\*\* me nr.\*\*\*, datë \*\*\*.12.2000. Çmimi i caktuar në kontratë është 500 000 lekë.

## **19.2 Pasuria nr. 2**

*Në D-Vett. deklarohet:* Dyqan me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, në të njëjtin pallat me banimin, me vleftë 1,400,000 lekë, ndërtuar në vitin 1997. Pjesët takuese 50 % me 50 % me bashkëshorten. Si burim i krijimit të pasurisë është deklaruar: të ardhurat personale dhe qira.

*Në DV-2003 deklarohet:* Bibliotekë me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, në të njëjtin pallat me apartamentin, me vleftë 1,800.000 lekë. Pjesët takuese 50 % me 50 % me bashkëshorten. Si burim i krijimit të pasurisë është deklaruar: të ardhura personale.

*Në fashikull të Komisionit është administruar:* Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., e datës \*\*\*.10.2001, lidhur në \*\*\* para noteres \*\*\*, me palë shitëse \*\*\* dhe \*\*\* me palë blerës \*\*\* dhe Xhezair Zaganjori me 6 bashkëpronarë të tjerë. Objekti i kontratës është kati përdhe, me sipërfaqe 281 m<sup>2</sup>, regjistruar në ZRPP \*\*\* me nr.\*\*\*, datë \*\*\*.12.2000. Çmimi i caktuar në kontratë është 500 000 lekë.

## **19.3 Pasuria nr. 3**

*Në D-Vett. deklarohet:* Bodrum me sipërfaqe 65 m<sup>2</sup>, në të njëjtin pallat me banimin, me vlerë 800,000 lekë. Si burim i krijimit të pasurisë është deklaruar: të ardhura personale dhe qira.

*Në DV-2003 deklarohet:* Bodrum me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, në të njëjtin pallat me apartamentin, me vleftë 1,500,000 lekë (ku përfshihet edhe zyra), ndërtuar në vitin 1997. Pjesët takuese 50 % me 50% me bashkëshorten. Si burim i krijimit të pasurisë është deklaruar: të ardhurat nga qiraja e bibliotekës.

*Në fashikull të Komisionit është administruar:* Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. (e palexueshme) rep., nr. (e palexueshme) kol., e datës \*\*\*.10.2001, lidhur në \*\*\* para noteres \*\*\*, me palë shitëse \*\*\* dhe \*\*\* me palë blerës \*\*\* dhe Xhezair Zaganjori me 6 bashkëpronarë të tjerë. Objekti i kontratës është bodrum me sipërfaqe 281 m<sup>2</sup>, regjistruar në ZRPP \*\*\* me nr.\*\*\*, datë \*\*\*.12.2000. Çmimi i caktuar në kontratë është 500 000 lekë.

## **19.4 Pasuria nr. 4**

*Në D-Vett. deklarohet:* Zyrë me sipërfaqe 15 m<sup>2</sup> në të njëjtin pallat me banimin, me vlerë 400,000 lekë. Pjesët takuese 50 % me 50% me bashkëshorten. Si burim krijimi të pasurisë është deklaruar: të ardhura personale dhe qira.

*Në DV-2003 deklarohet:* Zyrë me sipërfaqe 20 m<sup>2</sup> në të njëjtin pallat me apartamentin, me vlefë 1,500,000 lekë (ku përfshihet edhe bodrumi). Pjesët takuese 50% me 50% me bashkëshorten. Si burim krijimi të pasurisë është deklaruar: të ardhura personale dhe qira.

***Në fashikull të Komisionit është administruar:*** Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol, e datës \*\*\*.10.2001, lidhur në \*\*\* para noteres \*\*\*, me palë shitëse \*\*\* dhe \*\*\* me palë blerës \*\*\* dhe Xhezair Zaganjori me 6 bashkëpronarë të tjerë. Objekti i kontratës është kati i parë me sipërfaqe 57 m<sup>2</sup>, regjistruar në ZRPP \*\*\* me nr.\*\*\*, datë \*\*\*.12.2000. Çmimi i caktuar në kontratë është 500 000 lekë.

## **19.5 Pasuria nr. 5**

*Në D-Vett. deklarohet:* Apartament me sipërfaqe 81 m<sup>2</sup>, në lagjen \*\*\*, \*\*\*, ndërtuar në vitin 2006, blerë për vlefën 32.000 USD, sipas kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.6.2006, lidhur në \*\*\* para noterit \*\*\*. Pjesët takuese 50% me 50% me bashkëshorten. Si burim i krijimit të pasurisë është deklaruar: me të ardhurat personale, qira.

*Në DV-2006 deklarohet:* Apartament me sipërfaqe 81 m<sup>2</sup>, në lagjen \*\*\*, \*\*\*, blerë për vlefën 32 000 USD. Pjesët takuese 50% me 50% me bashkëshorten. Për burimin e krijimit të pasurisë nuk ka përshkrim.

**20.** Komisioneri Publik, pasi vlerësoi provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, bazuar në interpretimin ligjor të dispozitave të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, konstaton se Komisioni ka arritur në përfundime të gabuara për sa i takon vlerësimin të pasurive të subjektit të rivlerësimit z. Xhezair Zaganjori.

20.1. Për pasuritë nr.1- 4, momenti i fitimit të pronësisë është i njëjtë ndaj dhe trajtimi i tyre do të bëhet së bashku. Me qëllim vlerësimin mbi saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklaramit, burimin e ligjshëm, mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit, fillimisht rëndësi merr identifikimi i origjinës së pronës, momenti i fitimit të pronësisë dhe akti që ka shërbyer për regjistrimin e tyre.

20.1.1.Nga shqyrtimi i akteve, Komisioneri Publik konstaton se origjina e krijimit të këtyre pasurive rezultojnë të jenë kontratat e shitjes të pasurive të paluajtshme, të lidhura më datë \*\*\*.10.2001 sipas të dhënave të përshkruara në pikat 19.1-19.4 sa më sipër.

20.1.1-a Kronologjia e fakteve ligjore e krijimit dhe disponimit të pasurisë nga pala shitëse paraqitet si në vijim:

- (i) Në favor të ish-pronarëve z. \*\*\* dhe \*\*\* (\*\*\*), Komisioni i Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Tiranë (KKKP), me vendim e datës \*\*\*.9.1994, u ka njohur pronësinë mbi një truall me sip. 592m<sup>2</sup>, prej të cilëve 207 m<sup>2</sup> janë kthyer si truall i lirë dhe 385 m<sup>2</sup> për t'u kompensuar.
- (ii) Me vendimin e datës \*\*\*.10.1995, Këshilli i Rregullimit të Territorit Tiranë (KRTT) ka vendosur të miratojë shesh ndërtimi për godinë 7-8 kat polifunkionale në favor të pronarëve z.\*\*\* dhe znj.\*\*\*.
- (iii) Pas ndërtimit të objektit, më datë \*\*\*.8.2000 është hartuar edhe Akt-Kolaudimi tekniko-ekonomik, ku investitor cilësohen sërish pronarët e truallit, z.\*\*\* dhe znj.\*\*\*. Ndër të tjera, akti-kolaudimi specifikon edhe disa rrethana për ndërtimin ku janë pasuritë e sipërcituara, i cili ka filluar në gusht të vitit 1996 dhe ka përfunduar në shtator 1997, me investitor z.\*\*\*

dhe znj.\*\*\* për vlerën faktike të investimit në shumën 38.000.000 lekë (tridhjetë e tetë milionë).

- (iv) Më datë \*\*\*.8.2001, investitorët kanë aplikuar pranë Zyrës së Regjistrimit Tiranë për regjistrimin e pronës, kërkesë pas së cilës është lëshuar edhe vërtetimi hipotekor i pronësisë në favor të z.\*\*\* dhe znj.\*\*\*.
- (v) Më datë \*\*\*.10.2001, janë lidhur 5 kontrata shit-blerje pasurie të paluajtshme me palë shitëse \*\*\* dhe \*\*\* dhe palë blerëse \*\*\* dhe Xhezair Zaganjori (të vetëm në 1 kontratë dhe me 6 persona të tjerë në 4 kontrata).

20.1.2 Komisioneri Publik konstaton se Komisioni në kontradiktë me provat ligjore të administruara në fashikull ka dalë në konkluzion të gabuar lidhur me momentin (kohën) e fitimit të pronësisë së këtij apartamenti dhe mënyrën e fitimit të tij. Komisioni konkludon se “...*momenti i fitimit të pronësisë nuk është viti 2001, kur janë hartuar kontratat e shitjes formalisht, por viti 1997, kur sendi i ri i zhvilluar urbanisht është përfunduar dhe krijuar.*<sup>10</sup> Në vlerësimin e Komisionerit Publik nuk është në kompetencën kushtetuese të Komisionit të vendosë se cila është mënyra e fitimit të pronësisë nëpërmjet *veprimit juridik*<sup>11</sup> (kontratës së shitjes me akt noterial) apo **fitimit me përzierje**<sup>12</sup> (objekt shqyrtimi gjyqësor). Prova e administruar gjatë hetimit të Komisionit, kontratat e shitblerjes të datës \*\*\*.10.2001, janë i vetmi veprim juridik, që dëshmon mënyrën e fitimit të pronësisë në këtë rast. Për rrjedhojë, pjesa arsyetuese e bërë nga Komisioni mbetet e nivelit teorik, ashtu sikurse edhe pretendimet e paraqitura nga subjekti mbeten në nivelin deklarativ, ku në të dyja rastet ato gjenden të pambështetura në provat dhe faktet e administruara për këtë qëllim. Momenti (koha) i kalimit të të drejtave pronësore është ajo që dëshmon akti ligjor i noterit publik, kontratat noteriale të shit-blerjes, në të cilat është materializuar vullneti i palëve para organit të ngarkuar nga ligji, referuar kjo nenit 83 dhe nenit 192 të Kodit Civil.

20.1.3 Nga aktet në fashikullin e Komisionit rezulton se *deklarimi i këtyre pasurive* nga ana e subjektit të rivlerësimit, për sa i përket **vlerës** së tyre, është i ndryshëm midis DV - 2003, D - Vett. dhe kontratave të shit-blerjes, sikurse pasqyrohet në tabelën në vijim:

Pasuritë e paluajtshme	Vlera e deklaruar në D - Vett.	Vlera e deklaruar në DV - 2003	Vlera sipas kontratës së shit-blerjes
Apartament banimi sip. 293 m <sup>2</sup>	5.800.000	7.400.000	500.000
Sipërfaqe dyqani/bibliotekë 70 m <sup>2</sup>	1.400.000	1.800.000	500.000
Sipërfaqe bodrumi 65 m <sup>2</sup>	800.000	1.500.000	500.000
Zyrë 20	400.000		500.000
<b>Totali pasurive te paluajtshme në 31.12.2003 (vlera të ndryshme)</b>	<b>8.400.000</b>	<b>10.700.000</b>	<b>2.000.000</b>

20.1.3-a Për sa më sipër konstatojmë se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht vlerën e pasurisë. Sipas kontratave të shit-blerjes, çmimi i blerjes i secilës prej këtyre pasurive është 500.000 lekë, dhe nuk pasqyron vlerën reale të tyre apo atë të deklaruar në masë të ndryshme përgjatë viteve, nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>10</sup> Faqje 9, prg.2 i vendimit të Komisionit.

<sup>11</sup> Kodi Civil, neni 83.

<sup>12</sup> Kodi Civil, neni 173.

20.1.3 Komisioneri Publik, ndryshe nga përfundimi i arritur nga Komisioni, se në rastin e lidhjes së këtyre kontratave noteriale të shit-blerjes “...shmangia (e barrës tatimore) është kryer duke shfrytëzuar boshllëqet ligjore... duke sjellë për pasojë evazion tatimor të ligjshëm”, vlerëson se mospërputhjet mbi vlerat reale të çojnë në konkluzionin se kontrata e shitjes e vitit 2001 është fiktive (sa për dukje), duke ngarkuar subjektin me përgjegjësi për deklarim të pasaktë në DV-2003 dhe mungesë të shpjegimit bindshëm të pasurisë së krijuar në D- Vett.

- (i) Qëllimi i fiktivitetit të kontratës së vitit 2001 rezulton të jetë regjistrimi në ZRPP i pasurisë me vlerë më të vogël, me qëllim shmangien e pagimit të detyrimeve fiskale në favor të buxhetit të shtetit, detyrim ky që rrjedh nga kalimi i pronësisë së pasurisë së paluajtshme. Ky detyrim fiskal parashikohet shprehimisht duke iu referuar nenit 11 të ligjit 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Pra, në këtë rast, ndryshe nga sa arsyeton Komisioni, nuk jemi përballë ndonjë boshllëku ligjor për të konkluduar sikundër parashtrohet në vendim se “Subjekti nuk mund të penalizohet për shkelje të dispozitave ligjore që nuk ekzistojnë”.
- (ii) Në vijim të këtij argumenti, vlen të nënvizojmë se në dosje është administruar me vlerën e provës edhe informacioni i përcjellë Komisionit, nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me shkresën e datës \*\*\*.4.2018. Në këtë shkresë, ZQRPP-ja informon Komisionin se “...nga verifikimi i referencave të kontratë-shitjeve mungojnë mandatet e pagesës së tatimit”, si dhe informon për bazën ligjore të llogaritjes së detyrimit tatimor duke argumentuar se “përlllogaritja e tatimit në këtë periudhë është bërë duke u bazuar në vlerën e transaksionit sipas ligjit 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, si dhe tabelës bashkëlidhur”.

20.1.4 Nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit rezulton po ashtu se *deklarimi i burimit të krijimit të ardhurave*, që kanë shërbyer për krijimin e pasurive nr.1-4, është i ndryshëm.

- i. Për pasurinë nr.1 në DV-2003, si burim krijimi, deklarohen të ardhurat nga shitja e apartamentit në \*\*\* dhe të ardhurat personale, ndërkohë në D-Vett., përveç tyre, deklarohen edhe të ardhurat nga qiraja.
- ii. Për pasurinë nr. 2 “Biblioteka”, në DV-2003, si burim krijimi, deklarohen të ardhurat personale, ndërkohë në D-Vett. deklarohen të ardhura personale dhe qira.
- iii. Për pasurinë nr. 3 “Bodrumi” në DV-2003, si burim krijimi, deklarohen të ardhurat nga qiraja e bibliotekës, ndërkohë në D-Vett. deklarohen të ardhura personale dhe qira.
- iv. Për pasurinë nr. 4 “Zyrë” në DV-2003, si burim krijimi, deklarohen të ardhurat nga qiraja e bibliotekës, ndërkohë në D-Vett. deklarohen të ardhura personale dhe qira.

Për sa më sipër konstatojmë se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht burimin e krijimit të pasurisë.

20.1.5 Nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit rezulton se subjekti i rivlerësimit deklaroi si moment të krijimit të këtyre pasurive periudhën pranverë-verë 1999, analiza financiare për burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive do të shtrihet brenda kësaj periudhe.

20.1.5-1 *Mbi të ardhurat nga shitja e apartamentit në \*\*\**, subjekti ka paraqitur kontratën noteriale nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.1.1999, shitur sendi në vlerën 3.950.000 lekë me palë shitëse subjektin e rivlerësimit bashkëshorten dhe dy prindërit dhe palë blerëse shtetasin \*\*\*.\*\*\*., për të cilin është paguar edhe detyrimi tatimor nga kalimi i pronësisë. Ky burim të ardhurash është i justifikuar ligjërisht.

20.1.5-2 *Të ardhurat personale të subjektit të rivlerësimit* në rend kronologjik deri në pranverë-verë të vitit 1999 deklarohen ato nga (i) punësimi si pedagog i së drejtës ndërkombëtare në Fakultetin e Drejtësisë, vitet 1980-1992, (ii) si kërkues shkencor në \*\*\* - Gjermani, (iii) si

këshilltar i studiove të avokatisë dhe shoqërive të huaja që operonin në Republikën e Shqipërisë gjatë viteve 1991-1992, (iv) si ambasador i Republikës së Shqipërisë në Gjermani vitet 1992-1997.

- i. Nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit rezulton se për punësimin si pedagog nga viti 1980-1992, këshillimet ligjore në vitet 1991-1992, shërbimin si ambasador nuk ka të dhëna lidhur me vlerat konkrete të të ardhurave të realizuara me qëllim kryerjen e analizës financiare.
- ii. Lidhur me të ardhurat e akorduara në formë burse nga \*\*\* - Gjermani, subjekti ka paraqitur vërtetime mbi kryerjen e studimeve (punë kërkimore dhe shkencore) sipas të cilave është paguar me bursë për periudhën janar 1998 - gusht 1999, në shumën 94.600 DM (rreth 7.000.000 lekë). Për efekt të analizës financiare, nuk identifikohet vlera e saktë e kursimit nga këto të ardhura, në mungesë të informacionit/dokumentacionit mbi shpenzimet e jetesës së subjektit dhe familjarëve të tij për këtë periudhë. Rezulton se për këtë burim të ardhurash, dokumentacioni i pranuar për administrim nga Komisioni nuk është në shqip, i papërkthyer dhe legalizuar, me qëllim konsiderimin e tyre sipas 4, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Të ardhurat personale të bashkëshortes, deri në pranverë - verë të vitit 1999, deklarohen ato nga punësimi si (i) mësuese për vitet 1989 - 1992, si dhe (ii) e punësuar pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për vitet 1998 - 2001. Mbi të ardhurat e realizuara si mësuese nuk është administruar dokumentacion mbështetës, ndërsa për punësimin pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. është paraqitur një vërtetim pagesash nga shoqëria, por mungon dokumentacioni provues për shlyerjen e detyrimeve tatimore.

20.1.5-3 *Për të ardhurat nga qiraja të përfituara deri në vitin 1999*, të cilat subjekti i ka deklaruar si burim krijimi për pasuritë e sipërpërmendura në D-Vett., vlerësojmë se për arsyet e parashtruara më lart në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit nuk asnjë titull pronësie/posedimi të pasurisë së paluajtshme (bibliotekë) para datës \*\*\*.10.2001 (lidhja e kontratës së shit-blerjes), rrjedhimisht të ardhurat nga qiraja para kësaj date nuk justifikohen ligjërisht.

20.1.5-3.a. Gjithashtu, sipas provave të administruara në fashikullin e Komisionit, rezultojnë dy akte, të cilat dëshmojnë për momentin (kohën) nga kur kanë filluar të gjenerohen të ardhura mbi këtë pasuri, si vijon:

i) Sipas deklaratës noteriale me nr.\*\*\* rep. dhe nr.\*\*\* kol., e datës \*\*\*.5.2016 lidhur në \*\*\* para noterit \*\*\*, nënshkruar nga znj.\*\*\*.\*\*\*, deklaroi se “*Jam bashkëpronare e një pasurie, sipas dokumenteve hipotekore...së bashku me \*\*\*.\*\*\*, \*\*\*.Zaganjori, Xh. Zaganjori, \*\*\*.\*\*\*, \*\*\*.\*\*\*, \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*. Me pëlqimin e bashkëpronarëve, në cilësinë e bashkëpronarit dhe njërit prej qiradhënësve, kam hartuar dhe nënshkruar kontrata për marrje vendi me qira për zyrë me zyrën e \*\*\*- Shqipëri për periudhën 2001-2006 (ndarë sipas viteve)*”. Pra, është pranuar viti 2001, si moment i fillimit të përfitimeve financiare nga qiraja.

ii) Sipas prokurës së posaçme nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., e datës \*\*\*.2.2003, lidhur në \*\*\*, para noteres \*\*\*, bashkëpronarët e kësaj pasurie kanë emëruar si përfaqësuese të tyre znj.\*\*\*.\*\*\*, së cilës i kanë dhënë të drejta dhe kompetenca të plota që, në emër dhe për llogari të tyre, të nënshkruajë kontrata për dhënie me qira të ambienteve që kanë në bashkëpronësi në godinën me adresë: Rruga “\*\*\*\*” \*\*\*. Pra është formalizuar viti 2003, si moment kur subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur delegojnë të drejtat e tyre, me qëllim përfitimin e qirasë.

20.1.6 Në përfundim, vlerësimi i Komisionit, se të ardhurat nga burimet e mësipërme janë konsideruar si të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe krijimin e pasurive është i gabuar, pasi të ardhurat nga burimet qira (për të gjithë periudhën e pretenduar) dhe të ardhura personale mbeten në nivel deklarativ dhe të pambështetura në dokumente provuese.

20.2 Sa më sipër, referuar gjendjes së akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të këtyre pasurive, pasi nuk provohet vlera reale e këtyre pasurive me dokumentacion mbështetëse si plan investimi dhe/ose fatura, preventiv apo situacion punimesh për të provuar vlerën e saktë të investuar për fitimin e pronësisë. Në këto kushte rezulton se edhe pas kalimit të barrës së provës ndaj subjekti, ky i fundit nuk ka arritur të justifikojë bindshëm burimin e krijimit të pasurive.

## 21. Pasuria nr. 5

Në D-Vett., subjekti deklaron apartament me sip. 81 m<sup>2</sup>, në lagjen nr.\*\*\*, \*\*\*, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me bashkëshorten e tij në raportin 50/50, blerë me anë të kontratës së shitblerjes nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.6.2006, për çmimin 32.000 USD. Burimi i krijimit i deklaruar, nga të ardhurat personale dhe të ardhurat e qirasë.

21.1 Në DV-2006, subjekti i rivlerësimit deklaron blerjen e pasurisë apartament në \*\*\*, më datë \*\*\*.6.2006 për vlerën 32.000 USD, si dhe deklaron si burim të ardhurash të ligjshme (i) tërheqjen dhe mbylljen e llogarisë bankare pranë \*\*\* (\*\*\*) në shumën 1.25 milionë lekë.

21.2 Gjatë procesit të rivlerësimit, në pyetësorët e administruar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit deklaron se për blerjen e këtij apartamenti është përdorur shuma e tërhequr nga Banka \*\*\* (sot \*\*\* Bank), si dhe diferenca është plotësuar me (ii) tërheqjen e shumës rreth 16.000 USD nga llogaria e përbashkët me bashkëshorten pranë Bankës \*\*\* (sot \*\*\* Bank). Sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, burimi i krijimit të kësaj pasurie (depozita e përdorur) ka qenë qiraja mujore e përfutur nga “\*\*\*\*” dhe kursimet kryesisht nga kjo e ardhur ndër muaj, të depozituara pranë Bankës \*\*\*, sot \*\*\*.

21.3 \*\*\* Bank, me shkresë nr. prot. KPK \*\*\*, datë \*\*\*.1.2018, konfirmon tërheqjen nga subjekti të shumës 1.2 mln lekë më datë \*\*\*.4.2006 nga llogaria personale në ALL (llogaria nga \*\*\* në vitin 2006), por nuk konfirmon deklaramin e subjektit mbi transaksionet në llogarinë e përbashkët me bashkëshorten, si dhe tërheqjen nga llogaria të shumës 16.000 USD, në vitin 2006. Kjo llogari e përbashkët rezulton e mbyllur për të gjithë shumën e akumuluar vetëm 2 vite më pas, në dhjetor 2008, dhe është përdorur për kryerjen e një transaksioni tjetër nga ana e subjektit të rivlerësimit.

21.4 Sa më sipër, referuar dhe pikës 2.11 të rekomandimit të ONM-së, Komisioneri Publik çmon se subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri nuk ka paraqitur asnjë provë për të provuar tërheqjen e 16.000 USD, deklaruar rishtazi si burim krijimi i pasurisë, në përgjigjet ndaj pyetësorit të Komisionit të datës 1 mars 2018. Si rrjedhim, diferenca prej rreth 1.760.000 lekë<sup>13</sup>, rezulton e pambuluar me të ardhura të ligjshme, në kuptim kjo të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

## 22. Burimi nga të ardhurat nga qiraja pas vitit 2001

Në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave nga qiraja, analiza financiare e parashtruar nga Komisioneri Publik shtrihet edhe për periudhën mbas vitit 2001, për të vërtetuar pagimin e detyrimeve tatimore për këto të ardhura, të cilat janë deklaruar si burim krijimi pasurie dhe mbulimin e shpenzimeve për vitet në vijim. Kështu, nga provat e administruara rezulton se:

22.1 Për qiratë e deklaruar për periudhën 2001 - 2003, subjekti ka paraqitur dokumentacion për të provuar pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfutur vetëm për vitin 2002, ndërkohë nuk

<sup>13</sup> Kundërvlera e diferencës 32.000 USD - 1.200.000 lekë, konvertuar me kursin mesatar të vitit 2006, sipas BSh.

rezulton të jetë provuar me dokumentacion provues pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara në vitet 2001 dhe 2003, me qëllim konsiderimin e këtyre të ardhurave si të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

22.2 Mbi të ardhurat e qerasë për vitet 2005 - 2006, subjekti ka paraqitur kontrata qiraje, me qiradhënës \*\*\*.\*\*\* dhe qiramarrës \*\*\*, si dhe kontratën me qiradhënës subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshorten dhe qiramarrës shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

- i. Për të ardhurat nga kontratat e qirasë si më sipër, rezulton se subjekti ka provuar me dokumentacion pagesat e detyrimeve tatimore nga “\*\*\*\*” vetëm për vitin 2006. Pagesa e detyrimeve tatimore vërtetohet dhe nga Drejtoria Tatimore Rajonale \*\*\*, me shkresën nr.\*\*\* prot. e datës \*\*\*.6.2018. Të ardhurat nga qiraja me “\*\*\*\*” për periudhën janar 2004 - dhjetor 2005, nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të kushtetutës, pasi subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues për pagesën e tatimit në burim. Kontratat e depozituara nuk kanë të përcaktuar nëse shuma e specifikuar në kontratë është në vlerë bruto apo neto, si dhe palën përgjegjëse për pagimin e detyrimit tatimor. Vetëm në kontratën e vitit 2006 saktësohet kjo marrëdhënie kontraktuale mes palëve.
- ii. Për të ardhurat nga kontrata me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., subjekti ka paraqitur (i) kontratat e qirasë për vitet 2005 dhe 2006, (ii) një vërtetim të shoqërisë të datës \*\*\*.4.2016, që ka derdhur tatimin në burim, si dhe (iii) dy urdhër-transfera të sigluara nga urdhëruesi shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me datë \*\*\*.12.2005 dhe \*\*\*.12.2005, drejtuar Bankës \*\*\*, por nuk është paraqitur dokumentacion provues mbi vërtetimin e pagesës nga organet tatimore. Si rrjedhim, në mungesë të konfirmimit mbi ekzekutimin e pagesës së detyrimeve tatimore, të ardhurat nga qiraja me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., këto të ardhura nuk mund konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

22.3 Mbi të ardhurat nga qiraja për vitin 2007, rezulton se subjekti ka paraqitur (i) kontratën lidhur datë \*\*\*.5.2007, ndërmjet \*\*\*. \*\*\* si qiradhënës dhe \*\*\* Shqipëri, përfaqësuar nga \*\*\*.\*\*\* (njëkohësisht bashkëpronar në këto pasuri), për dhënien me qira të një sip. 100 m<sup>2</sup>, me afat 3-mujor, për çmimin 550 euro/muaj. Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se përfituesi është nënshkruesi i kësaj kontrate, \*\*\*.\*\*\* (i cili ka arkëtuar shumat sipas mandatpagesave, të paraqitura nga subjekti). Megjithatë për këto të ardhura rezulton të jenë paguar detyrimet tatimore, edhe kjo e ardhur nuk mund të konsiderohet si e ardhur e subjektit, pasi nuk ka asnjë dokumentacion provues se për realizimin e kësaj të ardhure është shfaqur vullneti ligjor i subjektit, si dhe nuk vërtetohet se pjesa takuese ka shkuar apo është ndarë edhe në favor të tij.

22.4 Sa më sipër, sikundër evidentohet dhe në rekomandimin e ONM-së (pika 2.8), këto të ardhura nuk konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, përderisa nuk vërtetohet pagimi i detyrimit tatimor.

## **23. Shpenzimet për shkollimin e fëmijëve**

**23.1** Nga verifikimi i deklaratave vjetore të interesave privatë të subjektit, transaksioneve bankare nga llogaria e tij dhe deklarimeve të tij gjatë procesit të rivlerësimit, konstatohen mospërputhje midis shpenzimeve të deklaruara mbi shkollimin e fëmijëve për vitet 2010 - 2019, përkatësisht në Mbretërinë e Bashkuar dhe RFGj.

23.1.1 Mbi shkollimin e të birit \*\*\*.\*\*\* në Angli.

- i. Në deklaratën vjetore të interesave privatë të vitit 2010, subjekti deklaroi pagesën për shkollimin e tij në shumën 12.500 paund. Ndërkohë, gjatë hetimit administrativ, i pyetur

nga Komisioni në pyetësorët e dërguar gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti rezulton të ketë ndryshuar vlerën e deklaruar në shumën prej 17.386 paund, shumë për të cilën ka paraqitur dokumentacion bankar.

- ii. Në deklaratën vjetore të interesave privatë të vitit 2011, subjekti ka deklaruar pagesën për shkollimin e të birit \*\*\*.\*\*\* në shumën 13.200 paund, shumë të cilën e rikonfirmon në pyetësorin e datës 25.12.2017. Ndërkohë, në përgjigjet e pyetësorëve të datës 1 mars 2018, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë ndryshuar sërish vlerën e deklaruar si shpenzim për vitin 2011 në shumën prej 20.565 paund, shumë për të cilën ka paraqitur dokumentacion bankar.

23.1-2 Subjektit i është kaluar barra e provës nga ana e Komisionit, mbi paraqitjen e dokumentacionit vërtetues të shpenzimeve të deklaruara (tarifë shkollimi, shpenzime akomodimi dhe jetese).

23.1-3 Rezulton se subjekti i rivlerësimit, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues mbi (i) kostot e shkollimit, (ii) akomodimit dhe (iii) jetesës gjatë shkollimit të djalit të tij në Mbretërinë e Bashkuar, duke mos deklaruar saktë vlerën e shpenzimit të kryer si në deklaratimet ndër vite, ashtu edhe në përgjigjet e pyetësorëve gjatë procesit të rivlerësimit, duke parashtruar si shpenzime për shkollim, shuma me vlera të ndryshme.

23.1.4 Mbi shkollimin e të birit \*\*\*.\*\*\* në RFGj.

Në deklaratën vjetore të interesave privatë për vitin 2014, subjekti ka deklaruar shpenzime shkollimi të të birit \*\*\*.\*\*\* shumën 9.000 euro, ndërkohë referuar lëvizjeve të llogarisë së subjektit nga RBAL për vitin 2014 rezulton se shuma e transferuar për këtë vit është 12.023 euro.

23.1.5-1 Subjektit i është kaluar barra e provës mbi paraqitjen e dokumentacionit provues të shpenzimeve të deklaruara ((i) tarifë shkollimi, (ii) shpenzime akomodimi dhe (iii) jetese, por rezulton se ka paraqitur vetëm dokumentacion mbi tarifën e shkollimit (\*\*\*) dhe disa pagesa akomodimi që i përkasin vitit 2017, edhe këto në gjuhë të huaj, pa përkthim/legalizim.

23.1.5-2 Rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të vërtetojë me dokumentacion provues kostot e plota të shkollimit, akomodimit dhe jetesës gjatë shkollimit të birit të tij në RFGj, si dhe ka kryer deklaratim të pasaktë të shpenzimeve të kryera për vitin 2014, pasi nuk ka deklaruar vlerën e plotë të shpenzuar.

**23.2 Komisioneri Publik** konstaton, se sikurse edhe për pasuritë e paluajtshme, subjekti edhe në këtë rast ka kryer deklaratime të pasakta dhe të pamjaftueshme. Subjektit të rivlerësimit, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, i është kërkuar qartësisht dokumentacion provues mbi (i) kostot e shkollimit (të tilla si dokumente bankare), (ii) akomodimit dhe (iii) jetesës së të birit të tij në Mbretërinë e Bashkuar. Megjithatë, ai nuk ka paraqitur ndonjë të dhënë të re apo dokument mbështetës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. E njëjta situatë rezulton me shpenzimet e kryera për shkollimin e të birit në RFGj. Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë paraqitur dokumente të mjaftueshme për të provuar/justifikuar gjithë shpenzimet e kryera mbi shkollimin e të birit në RFGj. Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i referohet vetëm pagesave të tarifave semestrale të shkollimit për periudhën e deklaruar 2013 - 2019 dhe disa pagesave që i korrespondojnë viteve 2017 - 2018.

## **24. Mosmbulimi i shpenzimeve vjetore me të ardhura të ligjshme**

24.1 Nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit, referuar kjo edhe në pikën 2.14 të rekomandimit të ONM-së, duke marrë në përlllogaritje të ardhurat e ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, rezulton se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet vjetore për vitet 2011, 2012 dhe 2014, konkretisht paraqitur në formë tabelare si vijon:



Zëra	2011	2012	2014
Të ardhura subjekti paga dhe honorarë SR	5,738,801.60	7,735,939.95	3,897,119.90
Të ardhura nga qiraja	480,000.00	432,000.00	1,764,000.00
Të ardhura BSH si notere	979,998.00	850,000.00	748,728.00
Të ardhura nga paga e djalit ***.***			965,000.00
Të ardhura nga interesat bankarë	114,789.00	296,000.00	483,255.00
<b>Total të ardhura (I)</b>	<b>7,313,588.60</b>	<b>9,313,939.95</b>	<b>7,858,102.90</b>
Shpenzime minimale jetese	482,143.00	482,143.00	482,143.00
Shpenzime nga karta e kreditit <sup>14</sup>	31,070.31	610,981.24	407,930.72
Shpenzime udhëtimi <sup>15</sup>	1,437,925.50	1,273,710.24	976,432.60
Pagesa shkollimi <sup>16</sup>	3,371,426.10	3,303,584.96 <sup>17</sup>	1,684,983.10
<b>Total shpenzime (II)</b>	<b>5,322,564.91</b>	<b>5,670,419.44</b>	<b>3,551,489.42</b>
<b>Shtuar llogaritë bankare gjatë vitit (III)</b>	<b>2,180,670.92</b>	<b>5,015,910.43</b>	<b>5,198,385.79</b>
<b>Diferenca për mbulimin e shpenzimeve (IV= I-II-III) ALL</b>	<b>(189,647.22)</b>	<b>(1,372,389.92)</b>	<b>(891,772.31)</b>

24.2 Metodologjia e përdorur në përlllogaritjet si më sipër bazohet në:

- Në të ardhurat e subjektit të deklaruara dhe verifikuar me dokumentacion mbi pagimin e detyrimeve tatimore.
- Të ardhurat nga qiraja janë llogaritur në vlerën neto, pasi është zbritur tatimi në burim i paguar, sipas kushteve të parashikuara në kontratë.
- Shpenzimet minimale të jetesës janë përlllogaritur sipas ILDKPI dhe bazuar në të dhënat statistikore të INSTAT.
- Shpenzimet e udhëtimit janë përlllogaritur nga të dhënat e sistemit TIMS për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij. Ndërsa për fëmijët \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, në mungesë të të dhënave nga sistemi TIMS, shpenzimet e udhëtimit janë përlllogaritur nga deklaratimet e tyre në pyetësorin e datës 25.12.2017.

24.3 Sa më sipër rezulton se për vitet 2011, 2012 dhe 2014, subjekti nuk justifikon dhe mbulon shpenzimet dhe kursimet me të ardhura të ligjshme, fakt për të cilin nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar të kundërtën.

## 25 Kërkimi i ankimit

26 Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, nenit, C/2, Ç, D dhe F/7 të aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriterin e pasurisë, referuar gjendjes së fakteve dhe provave, Komisioneri Publik nuk krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të tij, me qëllim arritjen e një niveli të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, sipas nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016;

27 Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose

<sup>14</sup> Nxjerrë nga lëvizjet e llogarisë në RBAL.

<sup>15</sup> Sipas regjistrimit të sistemit TIMS për subjektin dhe familjarët, përjashtuar udhëtimet e punës të vërtetuara me dokumentacion nga institucioni përkatës.

<sup>16</sup> Sipas transaksioneve nga llogaria bankare e subjektit pranë RBAL.

<sup>17</sup> Nga të cilat 320.000 lekë për djalin \*\*\*.\*\*\*, shkollë verore sipas lëvizjeve të llogarisë bankare të subjektit.

shkarkimin e subjektit ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

28 Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, pa pasur mundësinë ai vetë, Komisioneri Publik, që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave;

29 Bazuar në nenin D dhe F të aneksit të Kushtetutës, neneve 30-34 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

30 Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 46, datë 24.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

Florian BALLHYSA

I bashkëlidhet këtij ankimi:

1. Rekomandimi nr.\*\*\* prot., datë 6.8.2018, i ONM-së.